

**TECHNICAL DATA SHEET**

Issue: 1

Version: 2

**FLEXKOLL C2TE GRI / BARDHE****PËRSHKRIMI**

Ngjitës pllakash me bazë çimento, me force ngjitese te permiresuar, kundra rreshkitjes dhe kohe te gjate pune. Fale rerave te pergjedhura me granulometri percaktuar, additive te vecante dhe polimereve fleksibel, FLEXKOLL eshte i pershtashmem per ambiente te jashtme dhe te brendshme. Ofron ngjitje te shkëlqyer ne nenshtresat me baze Cimento, aplikim te lehtë, rezistente ndaj kushteve të motit.

**KLASIFIKIMI SIPAS STANDARTIT**

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse te permiresuar (2). rezistent ndaj rreshkitjes (T) dhe kohë punueshmërie e gjatë (E). I klasifikuar si ngjitës C2TE sipas standartit EN 12004. FLEXKOLL ka emetime shumë të ulëta të VOC-ve, (komponimeve organike të avullueshme), duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së aplikatoreve, sipas kerkesave EC1 Plus.

**PËRFITIME DHE KARAKTERISTIKA**

1. Ngjitje e shkëlqyer
2. Punueshmëri shumë e mirë dhe aplikim i lehtë
3. Pa rrëshqitje vertikale
4. Kohë punueshmërie e zgjatur
5. Fleksibilitet i pershtshem per ambiente me vibrim
6. Rezistencë e lartë ndaj lagështisë
7. I përshtatshëm për pllaka me format deri ne 120 cm
8. Për ambiente të brendshme dhe të jashtme
9. I rekomandueshëm për fasada, tarraca, ballkone dhe ambjente me ngrohje qendrore
10. Aplikim në trashësi deri në 15 mm

**FUSHA E APLIKIMIT**

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës, gres-porcelanit, klinkerit, terrakotes , pllakave mermerit dhe ato me absorbim të ulët. Për ngjitjen në bazamente me një lëvizshmëri të caktuar të tilla si ballkone, banjo, për dysheme dhe mure në ambiente të jashtme dhe të brendshme ku ka prani lagështie. Për dysheme me traçk të lartë si shkolla dhe spitale gjithashtu dhe ne dysheme me ngrohje qendrore. Për ambiente tregtare dhe industriale. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave për formate mesatare dhe të mëdhaja (5-120 cm).

**MENYRA E PERGATITJES SE PERZIERJES**

Përzieri 6.5-7 litra ujë të pastër me 25 kg FLEXKOLL përzieri masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziheni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë. Në kushte normale temperaturash (20°C)

**PËRGATITJA E SUPORTIT**

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpara aplkimit të produktit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.

**TECHNICAL DATA SHEET**

Issue: 1

Version: 2

**FLEXKOLL C2TE GRI / BARDHE****APLIKIMI**

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.

Pllakat vendosen mbi ngjitësin e freskët duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontakt të plotë. Për pllaka me format të madh, sipërfaqe të jashtme, fasada, dysheme me ngarkesë ose zona me prani uji, rekomandohet aplikimi i ngjitësit edhe në pjesën e pasme të pllakës për mbulim maksimal. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje të lëmuara. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe njëherë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre.

**KUJDES!**

Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përshtetshmëri në tharje të produktit).

- Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikoni shtrim të dytë të kollës në pllakë dhe bazament.
- Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitësit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit.
- Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 4-5 ditë pas ngjitjes vetëm nëse është bërë hidroizolimi.

**TECHNICAL DATA SHEET**

Issue: 1

Version: 2

**FLEXKOLL C2TE GRI / BARDHE****TË DHËNAT TEKNIKE**

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	E bardhë/Gri
Konsumi:	3-5 kg/m <sup>2</sup>
Rrëshkitshmëria:	≥0,5 mm
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa Vëllimore:	1.6 – 1.7 gr/cm <sup>3</sup>
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E
Ujë për përzierje:	6.5-7 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	35 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh
FN* pas 28 ditësh:	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
FN* pas zhytjes në ujë:	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
FN* pas reaksionit nga ngrohja:	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
FN* pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
FN* pas 30 min:	≥0,5 N/mm <sup>2</sup>
I shkelshëm:	Pas 24 orësh
Rreshkitshmeria:	≤ 0.5 N/mm <sup>2</sup>